

Progetto cofinanziato da



UNIONE  
EUROPEA



Comune di Pontassieve  
Centro Interculturale



MINISTERO  
DELL'INTERNO

Fondo europeo per l'integrazione di cittadini di paesi terzi

## MATERIALE DI SUPPORTO RILEVAZIONE SITUAZIONE IN INGRESSO

### 4.1 Testo narrativo/descrittivo

#### Letture – livello 1

Testo tratto da: Roald Dahl, *La fabbrica di cioccolato*, Salani

#### *Il Biglietto d'oro*

Charlie entrò nel negozio e depose la moneta umidiccia sul bancone.

- Una tavoletta di Ciococremolato Delizia Wonka al Triplogusto, prego- disse, ricordando quanto gli era piaciuta quella che aveva ricevuto per il suo compleanno.

Dietro al bancone c'era un signore grasso e ben pasciuto. Aveva grosse labbra e guanciotte piene e un immenso collo in cui le pieghe di grasso uscivano dal colletto della camicia formando una specie di ciambella di gomma. L'uomo si girò, allungò la mano per prendere la tavoletta, poi si voltò di nuovo e la porse a Charlie. Il ragazzo l'afferrò, la scartò rapidamente e si riempì la bocca con un enorme morso. Poi ne prese un altro... e un altro ancora... oh, che piacere infilarsi in bocca qualcosa di dolce e croccante! La pura gioia di riempirsi la bocca di cibo nutriente e delizioso!

Il negoziante mise il resto sul bancone e aggiunse: - Vacci piano, ragazzo. Se la mandi giù così, senza masticare, ti verrà il mal di pancia-

Charlie continuò a divorare il cioccolato. Non riusciva a fermarsi. In neanche mezzo minuto, l'intera tavoletta era scomparsa giù per la gola. Era rimasto quasi senza fiato, ma si sentiva benissimo, straordinariamente felice. Allungò una mano per prendere il resto. Ebbe un'esitazione. Gli occhi erano esattamente a livello del bancone e fissavano le monetine che vi stavano appoggiate. Erano tutti pezzi da cinque *pence*, nove in tutto. Certo non sarebbe successo niente se ne avesse spesa un'altra...

- Credo...- cominciò a dire a voce bassa, - credo proprio che... prenderò un'altra di quelle tavolette di cioccolato. Lo stesso tipo di prima, prego.-

- Perché no?- disse il grassone, allungando di nuovo la mano dietro di sé per prendere un'altra tavoletta di Ciococremolato Delizia Wonka al Triplogusto. Quindi la mise sul bancone.

Charlie la prese e ne strappò via l'involucro... e all'improvviso...da sotto la carta... apparve

un bagliore dorato.

Il cuore di Charlie si fermò.

- Ma è un Biglietto d'oro!- gridò il negoziante, facendo un salto di mezzo metro. - Hai trovato un Biglietto d'oro! Hai trovato l'ultimo Biglietto d'oro rimasto! Roba da non crederci! Venite gente, venite a vedere! Questo ragazzino ha trovato l'ultimo biglietto d'oro di Wonka! Sul serio! Guardate, ce l'ha ancora in mano!-

In pochi secondi, attorno a Charlie si era raccolta una piccola folla di una ventina di persone e altre ancora cercavano di entrare nell'angusto negozio. Tutti volevano vedere il Biglietto d'oro e il suo fortunato possessore.

Charlie era rimasto come paralizzato. Non era riuscito neanche a liberare del tutto il Biglietto d'oro dall'involucro. Era restato fermo, immobile, e stringeva forte la tavoletta con entrambe le mani mentre la gente faceva ressa attorno a lui vociando.

A un certo punto si rese conto che una mano gli si era posata gentilmente sulla spalla e, quando volse in su lo sguardo, vide un signore molto alto che gli stava vicino. - Senti, ragazzo- gli sussurrò l'uomo – perché non me lo vendi? Ti darò cinquanta sterline. E ti regalerò anche una bici nuova. D'accordo?-

\_ Ma è matto? - gridò una donna che gli stava altrettanto vicino. - Perbacco, io glene offrirei duecento di sterline per quel biglietto! Giovanotto, me lo vendi per duecento sterline?-

- Adesso basta!- esclamò il grasso negoziante, facendosi largo tra la folla e afferrando Charlie per il braccio. - Lasciate in pace questo ragazzo! Fate largo! Fatelo uscire!- E mentre lo accompagnava alla porta, bisbigliò all'orecchio di Charlie: - Non lo dare a nessuno, figliolo. Capito? A nessuno! Portalo subito a casa, prima che te lo possa perdere! Corri come il vento e non ti fermare finché non sei arrivato, capito?-

Charlie annuì (...) e, via, si mise a correre il più velocemente possibile. E mentre passava come il vento davanti alla fabbrica del signor Willy Wonka, si voltò un attimo e la salutò con la mano.

## **MREKULLIA**

Çarli hyri në dyqan dhe e lëshoi pesëmbëdhjetëqindarkëshen e lagur mbi banak.

-Një çokollatë Vonka me krem karamele-qumështi,-tha duke kujtuar sa shumë i kishte pëlqyer ajo çokollata që i dhuruan për ditëlindje.

Burri prapa banakut dukej i shëndoshë dhe i ushqyer mirë. Kishte buzë të trasha, faqe buçkane dhe gushë me pala. Palat e dhjemit rrotull qafës i rrinin mbi jakë si unazë gome.

Ai u kthye pas të kapte çokollatën dhe pastaj u rikthye dhe ia zgjati Çarlit. Çarli ia rrëmbeu, e çorri shpejt mbështjellësen dhe kafshoi një copë të madhe. Pastaj edhe një tjetër...dhe një tjetër... oh ç'kënaqësi që ishte të kullufisje ashtu, me copa të mëdha, një ushqim të fortë e të ëmbël! S'kishte gjë më të këndshme se ta mbushje gojën me ushqim të mirë e të fortë.

-Duket se ta paska vërtet ënda këtë çokollatë, biro,- i tha shitësi tërë qejf.

Çarli pohoi, me gojen mbushur me çokollatë.

Shitësi ia ktheu kusurin Çarlit mbi banak. -Mos u ngut,- i tha. -Kujdes, se të dhemb barku po e kapërdive kështu pa përtypur.

Çarli e kullufiti me uri ujku çokollatën, pa pushuar një grimëz. Dhe për më pak se gjysmë minuti e kishte përpirë të tërën. Sa nuk mbeti pa frymë, por ndihej mrekuullisht, jashtëzakonisht i lumtur. Zgjati dorën të merrte kusurin, pastaj u ndal. Sytë i arrinin vetëm pak sipër banakut. Ua nguli monedhave të argjendit që preheshin atje. Monedhat qenë të gjitha pesëqindarkëshe. Gjithë-gjithë ishin nëntë cope. Sigurisht s'prishej kushedi ç'farë sikur të priste njëkë më shumë...

-Dua , -foli i qetë, -dua të blej edhe një tjetër nga ato çokollatat, por ju lutem, e dua njëlloj

si atë që bleva më parë.

-Pse jo? –tha shitësi i ngjallmë dhe u zgjat prapa për të marrë një çokollatë tjetër me krem karamele-qumështi nga rafti. E mori dhe e la mbi banak.

Çarli e kapi dhe çorri letrën mbështjellëse, kur BEFAS...që poshtë letrës...vetëtiu një shndritje ARI PLOT SHKËLQIM!

Çarlit për pak sa s'i pushoi zemra!

-Bileta e Artë! –thirri shitësi, duke kërcyer e u hedhur përpjetë. –Të ra bileta e Artë! Gjete Biletën e Artë, të fundit që kishte mbetur! Hej, e morët vesh apo jo? Le të vijë e ta shohë gjithkush! Ky djali gjeti Biletën e Artë të Vonkës, të fundit fare! Ja tek është! Ja tek e ke në duar!

Dukej sikur shitësi po shkallonte nga gëzimi. –Në dyqanin tim, ja këtu e gjeti! –bërtiste. –E gjeti këtu, besa, në kioskën time të vogël! Le t'i thërrasë dikush gazetarët shpejt që ta marrin vesh! Kujdes tani, djalosh! Mos e gris duke e çmbështjellë! Se është gjë shumë e çmuar!

Brenda pak çastesh një turmë prej njëzet vetash u mblodh rrotull Çarlit dhe disa të tjerë po shtyheshin të hapnin rrugë e të hynin në shitore. Gjithkush donte të shihte Biletën e Artë dhe fatlumin e që e gjeti.

-Ku është Bileta? –bërtiste dikush. –Ngrije lart që ta shohin të gjithë!

-Ja tek e ke, ja atje! –bërtiste një tjetër.-Ja ku po e mban në duar! Shihe si shkëlqen floriri!

-Po si arriti ta gjente? –bërtiti plot zemërim një djalë shulak.- Njëzet copë çokollata në ditë kam blerë unë, për javë e javë të tëra, e s'gjeta gjë!

-Mendo pak ç'gjëra të mira do të marr falas ai,- tha me zili një djalë tër.-Për tërë jetën!

-Apo s'paska nevojë i shkreti, se qenka si karkalec! –tha një vajzë duke qeshur.

Çarli nuk kish luajtur hiç vendit. Madje as nuk e kishte nxjerrë krejt Biletën e Artë nga letra e çokollatës. Po rrinte aty pa lëvizur, duke e mbajtur çokollatën fort me të dy duart, ndërsa turma shtyhej e ngjitej pas tij. Po e kapte një ndjenjë e çuditshme pluskimi, sikur edhe ai po fluturonte lart në ajër si tullumbace. I dukej se këmbët nuk e preknin më tokën kurrkund. Dhe dëgjonte si i rrihte zemra fort në kraharor.

Pikërisht atëherë ndjeu një dorë që iu lëshua lehtë mbi sup dhe, sapo ngriti sytë, pa një zdap aty afër tij. –Dëgjo, -i pëshpëriti burri. –Ta blej unë për pesëdhjetë stërlina. Hë, si të duket? Dhe veç atyre do të jap edhe një biçikletë fringo të re. Mirë?

-Mos lojtët nga mendja? –foli një grua që po rrinte me këmbë pranë tij. –Ja pra, unë i jap dyqind stërlina për atë biletë. A do ta shesësh biletën për dyqind stërlina, djalosh?

-Mjaft tani me këto! –bërtiti shitësi i ngjallmë duke çarë rrugën mes turmës dhe duke e kapur Çarlin fort për krahu. –Lëreni djalin të qetë, po ju them. Hapni rrugën! Lëreni të dalë!

–Dhe posa e nxori Çarlin te dera, i pëshpëriti: -Mos ia lësho askujt. Shpjere drejt e në shtëpi, sa më parë, se ndryshe do ta humbasësh! Vrapo gjithë rrugës dhe mos ndalo askund sa të hysh brenda në shtëpi, dëgjove? Çarli tundi kokën.

-Edhe një gjë tjetër, - i tha shitësi i ngjallmë, pasi heshti një çast dhe i buzëqeshi Çarlit, - kam përshtypjen se ty të duhej diçka e tillë. Jam tepër i kënaqur që e gjete ti e jo ndonjë tjetër. Të uroj fat, biri im!

Faleminderit, -i tha Çarli dhe, me të dalë jashtë, ia dha vrapit mes dëbores me sa i hanin këmbët. Dhe kur fluturoi para fabrikës së Vili Vonkës u kthye drejt saj, e përshëndeti me dorë dhe nisi të këndonte.

## **Domande di comprensione del testo:/Pyetje mbi te kuptuarit e tekstit**

1. Chi sono i protagonisti del racconto?/ kush jane protagonistet e regimi?

A  Una donna e un signore alto/ nje grua e nje burri i gjate

- B  Un bambino grasso e Willy Wonka/ nje femije i shendosh e Willy Wonka  
C  Un ragazzo e un negoziante/ nje djal e nje shites

2. Dove si svolge il racconto?/ku zhvillohet ngjarja?

- A  Nella fabbrica di Willy Wonka/ ne fabriken e Willy Wonka  
B  A casa di Charlie/ ne shtepine e Charlie  
C  In un negozio/ ne nje dyqan

3. Quante tavolette di cioccolato mangia Charlie?/ sa copa çokollate ha Charlie?

- A  Solo una/ veten nje  
B  Due/dy  
C  Tre, e gli viene mal di pancia/tre, dhe e kap dhimbje barku

4. Che cosa trova Charlie nella tavoletta di cioccolato?/ çfare gjen Charlie ne çokollate

- A  Una moneta da cinque pence/ nje monete prej pese qindarkash  
B  Un sottile foglio d'oro/ nje flete te holle ari  
C  Una nocciola croccante/ nje lajthi te fresket

5. Che cosa fa Charlie subito dopo la scoperta?/çfare ben Charlie menjehere pas zbulimit?

- A  Rimane fermo per l'emozione/ Nuk leviz nga emocionet  
B  Urla di gioia/ çirret nga gezimi  
C  Risponde alle domande della gente/ Pergjigjet pyetjeve te njerzeve

6. Che cosa fa Charlie in seguito?/ çfare ben Charlie pastaj?

- A  Finisce di mangiare la cioccolata/ ha gjithë çokollaten  
B  Vende la sua scoperta per duecento sterline/ shet ate qe zbuloi per dyqind sterlina  
C  Si affretta verso casa passando davanti alla fabbrica/ shkon shpejt ne shtepi duke kaluar perpara fabrikes

7. Scrivi tu come continua il racconto./ shkruaj ti vazhdimin e tregimit

---

---

---

---

Punteggio: **1 punto** per ogni risposta corretta, domande 1-6  
**4 punti** da assegnare per la domanda 7, in base alla coerenza con il testo  
totale ----/ 10

Spunti per la produzione orale e/o scritta:

**Parla del tuo cibo preferito./ fol per ushqimin tend te preferuar**

---